



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr.1693/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Terminali” shpk, me seli ne Komunën e Hanit te Elezit, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat S.K. nga Lipjani, ndaj debitorit Republika e Kosovës- Qeveria e Kosovës - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me seli ne Prishtinë, te cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës –Dhomat e Shkalles se Parë, KPPP.nr.1588/22 dt.31.05.2023, me datën 20.02.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e debitorit Republika e Kosovës- Qeveria e Kosovës - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me seli ne Prishtinë, e ushtruar përmes përfaqësuesit Avokatura Shtetërore, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles e se Parë, KPPP.nr.1588/22 dt.31.05.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles e se Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1588/22 dt.31.05.2023, e ka refuzuar ne tërësi si te pabazuar prapësimin e debitorit Republika e Kosovës- Qeveria e Kosovës - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me seli ne Prishtinë, i paraqitur kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.55/22 dt.08.02.2022, të Përmbaruesit Privat Besnik H. Aliu, për territorin e Gjykatës Themelore ne Ferizaj, dhe te njëjtin urdhër e lëne në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljes esenciale te dispozitave te procedurës përmbarimore, vërtetimit te gabuar apo jo te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ankesën e debitorit dhe aktvendimin e atakuar ta anuloj me te gjitha veprimet e ndërmarra.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (LPP), gjeti se:

**-Ankesa e debitorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Terminali” shpk, me seli ne Komunën e Hanit te Elezit, me datën 08.02.2022, ka paraqitur propozim për përmbaremore ndaj debitorit Republika e Kosovës-Qeveria e Kosovës - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me seli ne Prishtinë, në bazë të dokumentit përmbaremore – Aktvendimit te Gjykatës Themelore ne Ferizaj-Dega ne Kaçanik–Departamenti i Përgjithshëm C.nr.194/16 dt.06.06.2019 i plotfuqishëm me Aktvendimin e Gjykatës se Apelit Ac.nr.3868/19 dt.28.08.2020 dhe i ekzekutueshëm nga data 04.11.2020. Përmbareuesi Privat Besnik H.Aliu nga Ferizaj, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbaremore P.nr.55/2022 dt.08.02.2022, ka lejuar përmbaremoren, me të cilën detyrohet debitori qe ta kthej gjendjen e mëparshme për te rivendosur rrethojat e metalit si dhe t’ia paguaj paditësit-kreditorit shpenzimet e procedurës kontestimore ne shumen prej 1,614.00 euro ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi.

Kundër urdhrin përmbaremore debitori ka paraqitur prapësim me datë 22.02.2022, duke theksuar se e konteston ne tërësi urdhrin për lejimin e përmbaremoren, duke u thirrur ne kronologji te çështjes, debitori njofton gjykatën se nuk ka marrë asnjë veprim me datën 07.02.2022 qe mund te trajtohet si pengim posedimi ashtu siç është deklaruar kreditori duke marrë parasysh se ngastrat objekt posedimi nr.356, 345/3 dhe 300/4 nuk janë ne pronësi te kreditorit Terminali shpk me seli ne Han te Elezit e as qe kanë qenë ndonjëherë, i referohet certifikatave qe ka cituar ne prapësim, propozon qe gjykata ta miratoj prapësimin e debitorit dhe ta shfuqizoj urdhrin përmbaremore me te gjitha veprimet e ndërmarra.

Ndaj prapësimin te debitorit, me datën 24.02.2022, kreditori ka parashtruar përgjigje, duke arsyetuar se prapësimi i debitorit nuk është i bazuar ne asnjë nga shkaqet qe parasheh neni 71 te LPP, pretendimi i debitorit se ne rastin konkret nuk ekziston pengim posedimi ngase ngastrat ne fjalë nuk janë ne pronësi te kreditorit është e pabazuar sepse pronësia ne çështjen e ligjshëmërisë se urdhrin përmbaremore nuk ka asnjë relevancë ne procedurën e pengim posedimit. Kreditori i referohet aktvendimit te plotfuqishëm te Gjykatës Themelore ne Ferizaj-Dega ne Kaçanik, propozon qe gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhri përmbaremore te mbetet ne fuqi ndërsa debitori te detyrohet t’ia kompensoj te gjitha shpenzimet e procedurës kreditorit.

Gjykata Themelore në Prishtinë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.1588/22 dt.31.05.2023, me të cilin e ka refuzuar ne tërësi si te pabazuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbaremore, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka arsyetuar se

prapësimi i debitorit është i pabazuar sepse nuk janë dhënë arsyet që prapësimi të pranohet. Gjykata në sqarim të arsyesimit i referohet Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik i cili është titull ekzekutiv dhe në këtë rast i referohet nenit 21, 22 par.1.1, 23 par.1, nenit 24 par.1 dhe 27 par.1 të LPP. Gjykata gjeti se dokumenti përmbartimor është dorëzuar në origjinal, është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm nga data 04.11.2020, ashtu që i plotësojnë kushtet ligjore nga neni 38 par.1 të LPP. Gjykata vlerësoi se pretendimet e debitorit nuk janë objekt shqyrtimi në procedurën përmbartimore sepse kjo procedure i nënshtrohet parimin të rigorozitetit formal në baze të cilit vlerësohen vetëm elementet formale të dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbartimi por jo edhe vlerësimi i rrethanave tjera, andaj edhe ka vendosur si në dispozitiv të vendimit të saj.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës e Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik- Departamenti i Përgjithshmen, është i formës së prerë me aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në rastin konkret është dokument përmbartues, konform nenit 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, e cila përcakton se: *“dokument përmbartimor është vendimi përmbartues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përmbartuese”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe 27 paragrafi 1 i po këtij ligji, ku përcaktohet se: *“dokumenti përmbartimor është i përshatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbartjes së detyrimit”*. Nga del se edhe kjo gjykatë pranon përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë se Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik C.nr.194/16 dt.06.06.2019 është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.3868/19 dt.28.08.2020 dhe është i ekzekutueshëm nga data 04.11.2020, është dokument përmbartimor dhe përbënë bazën juridike për përmbartim. Kjo gjykatë analizoi pretendimet e debitorit por të njëjtat vlerëson se nuk janë objekt shqyrtimi të kësaj procedure, andaj si të tilla i refuzoi ndërsa aktvendimin atakuar e vërtetoi.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkalles e Dytë ne Prishtinë për te vendosur nga ana e gjyqtarit individual ne shkallë te dytë bazohet ne dispozitën e nenit 3 par.2 te LPP me te cilën është paraparë se ne shkallen e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhoma e Shkalles se Dytë  
K.DH.SH.II nr.1693/23, me datë 20.02.2024

Gjyqtari,  
Ramush Bardiqi